

KAG-303/08

INTERIM ADMINISTRATION OF KOSOVA  
ADMINISTRATA E PËRKOHSHME E KOSOVËS  
PRIVREMENA ADMINISTRACIA KOSOVA

Republika e Kosovës  Republika Kosovo  
GJYKATA E QARKUT - OKRUŽNI SUD  
PEJË - PEÇ

**Prokuroria publike e qarkut**

**Pejë**

**PP – KT 88/08**

**CIR 2008/714/PEJ/EK**

3 Dhjetor 2008

Pranuar-Priljeno: 08. 12. 2008.			
Nj. pun. Org. jed.	Nr. Br.	Shtetje Prilog	Vlera Vrednost
30.	6	-	-

**GJYKATËS SË QARKUT**  
**PEJË**

1. Në bazë të neneve 304 dhe 304 të Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës (KPPPK), Deborah Wilkinson Prokurore publike ndërkombëtare, duke vepruar në cilësinë e Prokurores publike të qarkut të Pejës, nxjerrë këtë:

**AKTAKUZË**

**KUNDËR:**

Emri dhe mbiemri:	Gjelosh Krasniqi
Nofka:	"Jimmy"
Emri dhe mbiemri i babës:	[REDACTED]
Emri i nanës:	[REDACTED]
Mbiemri i vajzërisë së nanës:	[REDACTED]
Kombësia:	Shqiptar i Kosovës
Shtetësia:	Kosovar
Profesioni:	Bujk
Vendbanimi:	Fshati Napolë, KK Pejë
Vendi i lindjes:	Fshati Napolë, KK Pejë
Data e lindjes:	13 Shtator 1973
Gjendja martesore:	I pamartuar, pa fëmij
Niveli i arsimimit:	Po
Din shkrim dhe lexim:	Mesatar
Gjendja ekonomike:	U.S. Refugee Travel Document
Numri personal i identifikimit:	# A078220798
Procedura tjera penale në zhvillim:	I Akuzuar në Gjykatë e Qarkut të SHBA Distrikti Jugor i Nju Jorkut, Për shkak të veprave:

A gjendet në paraburgim:

(1) Veprat Federale kundër shtrëngimit - Grabitja, (2) Veprat Federale kundër shtrëngimit - komploti, dhe (3) Armbajtaj pa leje gjatë veprës penale me dhunë, 18 U.S.C. 1951 dhe 924(c), Regjistri gjyqsor No. S1 07 Cr. 907 (SAS); Fletë-arresti i pa përmbushur  
Në paraburgim nga datat 27 Maj 2008 deri me 24 Shtator 2008 dhe nga 7 Nëntor 2008 deri më sot

**PËRSHKRIMI DHE NOCIONET LIGJORE TË VEPRAVE PENALE  
(në bazë të nenit 305, paragrafi 1, nën-paragrafi 3 dhe nenit 305,  
paragrafi 1, nën-paragrafi 4 i KPPPK)**

**Vepra 1**

2. Se me 24 Mars 1999, Gjelosh Krasniqi, duke shkelur rregullat e ligjit ndërkombëtar që janë në fuqi gjatë luftërave, konflikteve të armatosura, apo okupimit, saktësisht nenet 3 dhe 147 të Konventës së Gjenevës në lidhje me Mbrojtjen e popullatës civile në kohë të luftërave (në tekstin e mëtejme Konventa e Gjenevës IV), dhe shkeljes së nenit 4 të Protokollit II të Konventës së Gjenevës, në fshatin Doblbarë të Komunës së Gjakovës, ka kryer:

A. Vepra të paligjshme, arrestimi, paraburgimi, marrja e pengjeve, moslejimi i mbajtjes së gjyqimit të drejtë dhe të paanshëm, trajtimi jonjerëzor, dhe vrasja e P■■■■ I■■■■ person civil;

B. Vepra të paligjshme të konfiskimit të pronës dhe plaçkitjes së pushkës AK-47, nj pistoletë 7.65 nga P■■■■ I■■■■, person civil;

C. Vepra të paligjshme të konfiskimit të pronës dhe plaçkitjes së pushkës M-48 nga T■■■■ K■■■■ person civil;

D. Vepra të paligjshme të konfiskimit të pronës dhe plaçkitjes së pushkës M-48 dhe pistoletës CZ 99 9 mm me numër 45981, nga Gj■■■■ Q■■■■, person civil;

E. Vepra të paligjshme të konfiskimit të pronës dhe plaçkitjes së pushkës M-48 dhe pistoletës Bronvik 7.65 mm, dhe municion nga M■■■■ P■■■■ person civil

3. Me këto veprime i pandehuri ka kryer veprën penale *Krim lufte kundër popullatës civile*, në kundërshtim me nenin 142 të Ligjit penal të Republikës Socialiste Federative të

Jugosllavisë (LP RSFJ), për të cilën është paraparë dënimi me burg jo më të vogël se pesë (5) vjet, dhe jo më të lartë se katërdhjetë (40) vjet.

### **SQARIMI I BAZAVE PËR PARASHTRIMIN E AKTAKUZËS (në bazë të nenit 305, paragrafi 1, nën-paragrafi 5 i KPPPK)**

4. Në muajin mars të 1999 ishte duke u zhvillua një konflikt i brendshëm i armatosur në territorin e Kosovës në mes të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe forcave të armatosura të Armatës Jugosllave (AJ), Ministrisë së brendshme të Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ), dhe Ministrisë së brendshme të Republikës së Serbisë. Forcat e armatosura të përfshira në konflikt kanë qenë nën komanda përgjegjëse dhe kanë shtruar kontrollin në pjesë të territorit të Kosovës, gjë që ju ka mundësuar të kryejnë operacione ushtarake të organizuara.

5. I pandehuri në kohën e kryerjes së veprave penale ka vepruar në emër të forcave të armatosura të UÇK-së dhe ka qenë pjesë e konfliktit; prandaj ka qenë obligim i tij që ti nënshtrohet rregullave ndërkombëtare për mbrojtjen e popullatës civile gjatë edhe konflikteve të armatosura ndërkombëtare edhe atyre të brendshme.

6. Viktimat e krimeve të luftës nga kjo aktakuzë janë anëtarë të popullatës civile dhe nuk kanë marr pjesë drejtpërdrejtë në veprimet armiqësore. Prandaj kanë qenë persona të mbrojtur sikurse që parashihet me Konventën e Gjenevës IV dhe Protokollit II të Konventës së Gjenevës. Duke u përqendruar në P███ I███ i cili ka qenë edhe bujk edhe pjesëtar i policisë lokale në kohën e kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, dhe të qenit pjesëtar i policisë lokale nuk ja humbë statusin e civilit të mbrojtur me Konventën e Gjenevës IV dhe Protokollit II të Konventës së Gjenevës. Shih E███ R███, E███ A███ dhe Rr███ D███, Gjykata supreme e Kosovës, Aeroporti i Prishtinës – KY 477/05, faqet 22 – 24, dhe *Deklarata për Policinë*, Rezoluta 690 (1979), Mbledhja e Kuvendit, Këshilli Europian.

7. Ekziston lidhja në mes të veprës së të pandehurit që paraqet krim lufte, ashtu si ngarkohet me këtë Aktakuzë, dhe konfliktit të armatosur të brendshëm që po zhvillohej në Kosovë në mars të 1999. Vetë ekzistimi i konfliktit të armatosur ka luajtur rol të rëndësishëm që ti mundësohet të pandehurit ti kryen veprat penale, dhe veprimet e të akuzuarit janë drejtpërdrejtë të lidhura me konfliktin e armatosur.

8. Viktima P███ L███ ishte në kohën kur është kryer vepra penale, një bujk 47 vjeçar, Shqiptar i Kosovës, i martuar me shtatë fëmijë që jetonte në fshatin Doblbarë të komunës së Gjakovës. Pas fillimit të konfliktit të armatosur në Kosovë, autoritetet komunale të Gjakovës e kanë punësuar P███ L███ si polic për fshatin Doblbarë. Fqiu i P███ P███ K███ e përshkruan atë si person “që nuk i ka ba keq askujt, nuk ka pas të keq me askënd në fshat, por ka punuar për qeverinë Jugosllave vetëm sa për ta mbajtur familjen”.

8. Në mbrëmjen e 24 marsit 1999, P███ L███ dhe anëtarët e familjes së tij ishin në shtëpinë e vëllai të P███ N███ I███. Rreth orës 20:00 – 20:30, i pandehuri Gjelosh

Krasniqi ka ardhë në këtë shtëpi me katër burra tjerë, të gjithë të veshur në uniforma kamuflazhi me shenja të UÇK-së, të armatosur me pushka AK – 47. Krasniqi kërkonte ti tregonin se cili nga ata ishte P [REDACTED] I [REDACTED] P [REDACTED] ka dalë para dhe është identifikuar se ishte P [REDACTED] L [REDACTED] Mandej Krasniqi me ushtarët tjerë të UÇK-së e kanë kontrolluar shtëpinë duke kërkuar armë, dhe kanë konfiskuar një pushkë AK – 47 dhe një pistoletë 7.65 mm që ishin të Pashkut. Pas kësaj Krasniqi dhe tjerët kanë shkuar nga shtëpia e N [REDACTED] L [REDACTED] duke e marr P [REDACTED] si të arrestuar, ashtu që të mund ti kontrolloni disa shtëpia tjera në fshat në kërkim të armëve. Mirëpo, Krasniqi e ka urdhërua njërin nga ushtarët e UÇK-së që ti vëzhgoj banuesit e shtëpisë së N [REDACTED] L [REDACTED]

10. Me P [REDACTED] si të arrestuar, Krasniqi me ushtarët tjerë shkuan atë natë në tri shtëpia tjera në fshatin Doblbarë. Kur i janë afruar shtëpisë së P [REDACTED] K [REDACTED], P [REDACTED] është lajmëruar duke thanë “Kumbarë T [REDACTED]” Kur e ka dëgjuar këtë, P [REDACTED] K [REDACTED] ka dalë në oborrin e tij dhe e ka pa P [REDACTED] me duar të lidhura pas shpine, të rrethuar nga ushtarët e UÇK-së, dhe njërin nga ata e ka njohtë se ka qenë Gjelosh Krasniqi. P [REDACTED] K [REDACTED] ka thanë “Çka po ndodhë P [REDACTED]” dhe P [REDACTED] është përgjigjur “Nuk e di.” Njeri nga ushtarët e UÇK-së ka kërkuar ta takoj T [REDACTED] K [REDACTED], axhën e P [REDACTED] K [REDACTED] Kur ka dalë T [REDACTED] K [REDACTED] ushtarët kanë kërkuar nga ai që dorëzojë pushkën e tij M-48, dhe ai e bëri këtë. Sipas T [REDACTED] K [REDACTED] ai e kishte lejen për këtë pushkë, kështu që ishte në posedim ligjor të pushkës në momentin kur i është konfiskuar.

11. Krasniqi me ushtarët e UÇK-së kanë shkuar edhe në shtëpi të M [REDACTED] P [REDACTED] Atje Krasniqi i ka treguar M [REDACTED] librezën e identifikimit të policisë të P [REDACTED], dhe e ka pyetur se a e njeh këtë person. M [REDACTED] është përgjigj se e njeh pasi që P [REDACTED] ka qenë Kumbarë i tij. Krasniqi ka kërkuar nga M [REDACTED] gjithashtu që ti dorëzojë armët e tij. M [REDACTED] e ka ba këtë, dhe ka dorëzuar një pushkë M – 48, dhe pistoletë Bronvik 7.65 mm, dhe pak municion. Kur e ka ba këtë, M [REDACTED] i ka thanë Krasniqit se “Unë po ju jap armët, por po frikohem se një ditë mund të vini të më merrni mua dhe djemtë e mi.” Krasniqi është përgjigj “Ne nuk do të vijmë të marrim ty sepse ti je sjell mirë”.

12. Në fund Krasniqi me ushtarët kanë shkuar në shtëpinë e Gj [REDACTED] Q [REDACTED], dhe i kanë thanë Q [REDACTED] se ata duhet të hyjnë brenda dhe ti marrin armët. Q [REDACTED] i është përgjigjur se ata nuk kanë nevojë të hyjnë brenda sepse ai do ti ju dorëzoj armët, dhe ja ka dorëzuar një pistoletë CZ 99, numër 45981, Gjelosh Krasniqit, dhe një pushkë M-48 një ushtari tjetër të UÇK-së. Sipas Q [REDACTED], ai e kishte lejen për këtë pushkë, kështu që ishte në posedim ligjor të pushkës në momentin kur i është konfiskuar.

13. rreth orës 23:30 Gjelosh Krasniqi dhe ushtarët tjerë të UÇK-së, janë kthyer të shtëpia e N [REDACTED] L [REDACTED] së bashku me P [REDACTED] për ta marr ushtarin i cili qëndronte roje atje. Ushtarët kanë thanë se P [REDACTED] duhet të shkoj me ata në Shtabin e UÇK-së në Jabllanicë. Vëllai i P [REDACTED], M [REDACTED] L [REDACTED] ka pyetur se pse po e marrin P [REDACTED] duke ju shpjeguar se ai ka shumë fëmijë. Krasniqi është përgjigjur se P [REDACTED] po e marrin sepse ka qenë polic lokal. Ai gjithashtu ka thanë “Nëse G [REDACTED] dhe M [REDACTED] e lirojnë, atëherë edhe ne e lirojmë”. Krasniqi ka urdhërua që anëtarët e familjes L [REDACTED] të mos lëvizin nga shtëpia, dhe mandej ai me ushtarët dhe me P [REDACTED] shkuan nga oborri i shtëpisë, duke e mbyllur derën e oborrit pas tyre. Gj [REDACTED] I [REDACTED] i biri i P [REDACTED] e ka hapë derën e oborrit duke u munduar të shoh se ku po qonin babën e tij, por kur Krasniqi e ka vërejtur ate, ai ka

bërtitur “Mbylle derën se do ta vras si qenin!” Mandej Gj [redacted] L [redacted] është kthyer në oborr dhe e ka mbyllë derën.

14. Pasi që është marr nga Krasniqi dhe ushtarët e UÇK-së me 24 mars 1999, P [redacted] L [redacted] ka mbetur i pagjetur dhe familja e tij supozon se ka vdekur. Anëtarët e familjes së P [redacted] i ka dhanë mostrat e gjakut organizatave ndërkombëtare për analiza dhe krahasime të ADN-së, mirëpo deri me sot të mbeturat trupore të P [redacted] nuk janë gjetur apo identifikuar.

15. Pas përfundimit të konfliktit, Gj [redacted] L [redacted] e ka takuar Krasniqin në fshatin Doblbarë dhe e ka pyetur se ku është P [redacted]. Krasniqi është përgjigjur se nëse ai dëshiron të din se çka ka ndodhur me babën e tij, ai duhet të shkojë në Shtabin e UÇK-së në Jabllanicë dhe të bisedoj me L [redacted] B [redacted] dhe M [redacted] N [redacted] (të dy komandantë të lartë të UÇK-së). Krasniqi i ka thanë gjithashtu Gj [redacted] “unë e kam lanë babën tënd në fshatin Maznik dhe nuk di asgjë për te. Mos u mundo ta kërkosh tepër sepse edhe ti mund të zhdukesh sikurse baba yt”.

16. Gj [redacted] L [redacted] ka paraqitë te hetuesit ndërkombëtar për Tribunal Ndërkombëtar Penal për ish Jugosllavinë (ICTY) dhe te policia e UNMIK-ut se motra e tij M [redacted] N [redacted], ka jetuar dhe punuar në Nju Jork në vitin 2002, kur Krasniqi ka shkuar në zyrën e sajë (në agjension turistik) dhe i ka thanë, “Dëgjo, unë ta kamë vra babën dhe nuk mërzitem për këtë aspak, dhe as për ty.” Krasniqi i ka thanë gjithashtu M [redacted] N [redacted] se baba i sajë është varrosur jo larg nga shtëpia e tyre në fshatin Doblbarë.

17. se Krasniqi ka qenë anëtarë i UÇK-së është vërtetuar me dokumentet e lëshuar nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe ato që janë marr nga ai në momentin e arrestimi të tij me 27 maj 2008. Një nga këto dokumente me titull “Vërtetim”, i lëshuar nga TMK, Zona e Tretë e Mbrojtjes, Njësia ndërlidhëse ushtarako-civile, Seksioni mjekësor, me 21 maj 2008, dëshmon se Gjelosh Krasniqi ka shërbyer si ushtar i UÇK-së në Shtabin e Nepoles nga datat 16 qershor 1998, deri me 9 shtator 1998, dhe në Brigadën 132 nga 9 shtatori 1998 deri me 20 qershor 1999. Sipas këtij “Vërtetimi” Krasniqi është plagosur me datën 5 prill 1999 duke luftuar në Jabllanicë, Komuna e Gjakovës.

18. ICTY ja ka dhanë Policisë së UNMIK-ut dokumentet e konfiskuara të UÇK-së nga autoritetet Jugosllave. Njeri nga ata dokumentet është raporti i njësisë së inteligjencës të UÇK-së, të komandës së zonës operative të Dukagjinit, të datës 21 mars 1999. Ky raport e përshkruan Gjelosh Krasniqin “nga Nepolja” si personi i cili kalon çdo ditë nga gjysmë ore brenda komandës lokale të Komandës së zonës operative të Jabllanicës.

19. ICTY ja ka dhanë edhe një dokument tjetër Policisë së UNMIK-ut me titull “Proces verbal” i cili është përpiluar nga Njësia së UÇK-së e inteligjencës e Komandës së zonës operative të Dukagjinit me 25 mars 1999. Ky procesverbal është nga marrja në pyetje e P [redacted] L [redacted] nga personi apo personat e paidentifikuar. Procesverbali paraqet me qëllim “pranimin” e P [redacted] L [redacted] ku ai pranon se ka qenë i punësuar nga Kuvendi komunal i Gjakovës si polic lokal qysh në tetor të 1998, për të siguruar raporte për policinë serbe në lidhje me aktivitetet ushtarake të UÇK-së në rajonin e fshatit të tij.

20. "Procesverbali" dëshmon se Gjelosh Krasniqi e ka arrestuar P■■■■ L■■■■ me 24 mars 1999. Ata gjithashtu e kanë shënuar se P■■■■ L■■■■ e ka pasë me vete edhe librezën e identifikimit policor, dhe se është pushkatuar pa vonim me 25 mars 1999 nga Brigada 132. Vendi ku është varrosur P■■■■ është lanë i paplotësuar.

**PROPOZIMI PËR GJYKIM**  
(në bazë të nenit 305, paragrafi 1, nën-paragrafi 6 i KPPPK)

21. Prokurorja publike propozon që të caktohet seanca kryesore për këtë lëndë dhe të mbahet në Gjykatën e qarkut në Pejë.

**PROPOZIMET PËR PROVAT DHE DËSHMITARËT**  
(në bazë të nenit 305, paragrafi 1, nën-paragrafi 7 i KPPPK)

22. Prokurore publike ndërkombëtare e qarkut kërkon që për seancën kryesore të ftohen këta persona:

Prokurore publike ndërkombëtare Deborah Wilkinson

I pandehuri Gjelosh Krasniqi

Avokat i mbrojtjes Mr. Haxhi Millaku

23. Prokurore publike ndërkombëtare propozon që të ftohen këta dëshmitar për të dhanë dëshmi në seancën kryesore:

Pala e dëmtuar Gj■■■■ I■■■■

Pala e dëmtuar Z■■■■ L■■■■

Pala e dëmtuar M■■■■ I■■■■

Pala e dëmtuar P■■■■ L■■■■

Pala e dëmtuar B■■■■ L■■■■

Pala e dëmtuar E■■■■ I■■■■

Pala e dëmtuar M■■■■ N■■■■

M■■■■ P■■■■

Gj■■■■ Q■■■■

P■■■■K■■■■

T■■■■K■■■■

Pekka Haverinen, Hetues i ICTY

Th■■■■O■■■■ Përkthyes i ICTY

E■■■■G■■■■ Përkthyes i ICTY

E■■■■Sh■■■■, Përkthyes i ICTY

A■■■■G■■■■ Përkthyes i ICTY

Polici H■■■■A■■■■, SHPK # 5529

Policja Z■■■■Z■■■■, SHPK # 0353

Polici Ismet Jemini, SHPK # 4487

Policja M■■■■F■■■■, SHPK # 0041

Polici K■■■■R■■■■CP # 15405

24. Prokurore publike ndërkombëtare propozon që gjykata ti lexon dhe ti merr parasysh këto dokumente gjatë seancës kryesore:

- (1) Raporti Policor i Njësisë për krime të luftës së Policës së UNMIK-ut numër 2002-00047
- (2) Deklarata e dëshmitarit Gj■■■■I■■■■e datës 17 - 18 janar 2003
- (3) Deklarata e dëshmitarit Gj■■■■I■■■■e datës 2 - 3 shkurt 2004
- (4) Deklarata e dëshmitarit Gj■■■■L■■■■e datës 16 janar 2008
- (5) Deklarata e dëshmitarit Gj■■■■L■■■■e datës 1 mars 2008
- (6) Deklarata e dëshmitarit Gj■■■■I■■■■e datës 26 gusht 2008
- (7) Deklarata e dëshmitarit P■■■■L■■■■e datës 16 janar 2008
- (8) Deklarata e dëshmitarit P■■■■K■■■■e datës 16 mars 2008 dhe foto-reshtimi
- (9) Deklarata e dëshmitarit Gj■■■■Q■■■■e datës 11 prill 2008
- (10) Deklarata e dëshmitarit B■■■■I■■■■e datës 16 mars 2008
- (11) Deklarata e dëshmitarit M■■■■P■■■■e datës 11 prill 2008
- (12) Deklarata e dëshmitarit E■■■■L■■■■e datës 16 mars 2008

- (13) Deklarata e dëshmitarit M [REDACTED] N [REDACTED] e datës 7 - 9 dhjetor 2005
- (14) Proces verbali cili i Njësisë së UÇK-së e inteligjencës e Komandës së zonës operative të Dukagjinit të datës 25 mars
- (15) Shënimet e Shërbimit të inteligjencës së UÇK-së
- (16) Shënim *Në lidhje me dokumentet e kërkuara për të aplikuar për Skemën e Familjeve Martire, Invalidëve dhe Viktimave civile*
- (17) Vërtetimi i datës 21 maj 2008, Protokoli 15/06, seria 62, e lëshuar nga TMK
- (18) Vërtetimi i datës 21 maj 2008, Protokoli 09/08, e lëshuar nga TMK
- (19) Dokumentet e konfiskuara nga Gjeloš Krasniqi gjatë arrestimit me 26 maj 2008
- (20) *Formulari për të drejtat e personit të arrestuar* i përpiluar për Gjeloš Krasniqi me 18 qershor 2008
- (21) *Formulari Intervista/marrja në pyetje e të pandehurit* e përpiluar për Gjeloš Krasniqin me 18 qershor 2008
- (22) Raporti para vdekjes, INV NRO # 0592/INV/05, i datës 29 nëntor 2005
- (23) Raporti para vdekjes, INV NRO # 0031/INV/07, i datës 17 Janar 2008
- (24) Raporti shtesë i Policit H [REDACTED] A [REDACTED], SHPK # 5529, i datës 3 mars 2008
- (25) Raporti plotësues i Policit H [REDACTED] A [REDACTED], KPS # 5529 i datës 5 mars 2008
- (26) Raporti plotësues i Policit H [REDACTED] A [REDACTED] KPS # 5529 i datës 25 mars 2008
- (27) Përmbledhja e informatave të mbledhura për hetimet nga Polici H [REDACTED] A [REDACTED], SHPK # 5529, i datës 29 prill 2008
- (28) Faqja e shtypur e data bazës Qendrës nacionale informative për krime
- (29) Memo nga Polici A [REDACTED] Th [REDACTED], Zyra ndërlidhëse e UNMIK të Interpolit drejtuar Policit K [REDACTED] R [REDACTED] CP # 15905, e datës 17 qershor 2008
- (30) Letra nga Agjenti special i FBI Cindy Coppola, drejtuar Policit K [REDACTED] R [REDACTED] CP # 15905, e datës 24 qershor 2008
- (31) Aktakuza kundër A [REDACTED] N [REDACTED] J [REDACTED] M [REDACTED] D [REDACTED] M [REDACTED] L [REDACTED] P [REDACTED], D [REDACTED] C [REDACTED], E [REDACTED] Gj [REDACTED], dhe Gjeloš Krasniqi në Gjykatën e qarkut SHBA, Distrikti Jugor i Nju Jorkut, lënda penale numër S1 07 Cr. 907 (SAS)
- (32) Fletë-arresti për Gjeloš Krasniqin i lëshuar me 18 dhjetor 2007 nga Gjyqtari Ronald L. Ellis, U.S. Magistrate, Southern District of New York, (Distrikti Jugor i Nju Jorkut) Regjistri No. S1 07 Cr. 907 (SAS)



- (33) Aktgjykimi kundër A [REDACTED], N [REDACTED], J [REDACTED], M [REDACTED], D [REDACTED], M [REDACTED], I [REDACTED], P [REDACTED], D [REDACTED], C [REDACTED], dhe E [REDACTED] Gj [REDACTED], Gjykata e qarkut SHBA, Distrikti Jugor i Nju Jorkut, lënda penale numër S1 07 Cr. 907 (SAS)
- (34) Fotokopjet e kopertinës dhe të gjitha faqeve nga origjinali i Dokumenti i Udhëtimit i SHBA për Refugjatët (U.S. Refugee Travel Document) i Gjelosh Krasniqit, i lëshuar me 8 mars 2007, ka skaduar me 8 mars 2008
- (35) Kopja e data bazës Pisces (“Përmbledhja e udhëtimeve”) për Gjelosh Krasniqi
- (36) Kopja e data bazës Pisces (“Identiteti” dhe “Dokumenti i udhëtimit”) për Gjelosh Krasniqi
- (37) Kopja e I.D. faqes për Gjelosh Krasniqi U.S. Refugee Travel Document lëshuar me 8 mars 2005, ka skaduar me 8 mars 2006
- (38) Kopja e I.D. faqes për Gjelosh Krasniqi U.S. Refugee Travel Document lëshuar me 1 dhjetor 2003, ka skaduar me 1 dhjetor 2004
- (39) Fotokopjet dokumentit të udhëtimit të Gjelosh Krasniqit shënimet nga Pisces nga Policia kufitare e Kosovës.

25. Prokurore publike ndërkombëtare propozon që gjykata ti shqyrton dhe ti merr parasysh këto prova fizike gjatë seancës kryesore:

Fotografinë e viktimës P [REDACTED] L [REDACTED]

**PROPOZIMI PËR VAZHDIMIN E PARABURGIMIT  
(në bazë të nenit 305, paragrafi 2, i KPPPK)**

26. Prokurorja publike e qarkut propozon që kolegji i cili do ta shqyrtoj paraburgimin sis nenit 306, paragrafi 5 të KPPPK, ta zgjas paraburgimin kundër të pandehurit. Bazat për vazhdimin e paraburgimit janë si në vijim:

***Ekziston dyshimi i bazuar set Gjelosh Krasniqi ka kryer veprat penale nga Aktakuza  
(neni 281, paragrafi 1, nën-paragrafi 1 i KPPPK)***

27. Prokurori publik i qarkut i ja drejton vëmendjen Gjykatës në faktet e lartpërmendura në paragrafët 4-20, *Sqarimi i bazës për parashtrimin e Aktakuzës*, si mbështetje të konkludimit se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale *Krime lufte kundër popullatës civile*, neni 142 LP RSFJ.

***Rrethanat tregojnë se ekziston rreziku nga arratisja (nenit 281, paragrafi 1, nën-paragrafi 2, pika (i) i KPPPK)***

28. I pandehuri paraqet rrezik të lartë se do të ikë nga këto shkaqe:

A. I pandehuri ka ikë nga Shtetet e Bashkuara ku i është pranuar statusi i refugjatit, kur zyrtarët e organeve federale të zbatimi të ligjit të Shteteve të Bashkuara janë munduar që ta arrestojnë për veprat penale të kryera si bashkëpunues i Familjes Gjenoveze që merret me Krimin të Organizuar;

B. Gjykata e qarkut e SHBA-ve Southern District of New York, (Distrikti Jugor i Nju Jorkut) ka lëshuar fletë-arrestin për të pandehurin, për shkak të veprave serioze penale, Grabitje, Organizimi i kryerjes së grabitjes, dhe armëmbajtje pa leje, (Regjistri No. S1 07 Cr. 907 (SAS))

C. Prokurorja publike ndërkombëtare Deborah Wilkinson ka biseduar personalisht me telefon me Ndhimës Kryeprokurorin e SHBA-ve Elie Honig në lidhje me statusin e Krasniqit në procedurat e parashkuara në paragrafin B më lartë; Z. Honig e ka vërtetuar edhe gojarisht edhe me anë të E-mailit se Gjëlosh Krasniqi nuk është arrestuar asnjëherë, nuk është paraqitur para autoriteteve për procedurë penale dhe as nuk ka parashtruar dorëzani para këtyre autoriteteve në procedurën penale S1 07 Cr. 907 (SAS) in U.S. District Court in New York;

D. Informatat nga data baza *Pisces* e Policisë kufitare të Kosovës dhe vulave hyrëse dhe dalëse në Dokumentin e Udhëtimit (Travel Document) të pandehurit tregojnë se i pandehur shpesh udhëton nëpër shtete të ndryshme të Ballkanit;

E. Prej muajit janar e deri në maj 2008 i pandehuri ka hyrë dhe ka dalë nga Kosova shumë herë, dhe derisa ishte në Kosovë ai qëndronte në hotel e jo në shtëpinë e tij familjare, dhe i ndërronte veturat duke tentuar qartazi ti shmangët arrestimit nga policia; dhe

F. I pandehuri është i pamartuar dhe nuk ka pjesëtar të familjes në Kosovë për të cilët kujdeset.

***Ekzistojnë bazat të besohet se Gjëlosh Krasniqi do ta pengonte zhvillimin e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitar apo në bashkëkryes (neni 281, paragrafi 1, nën-paragrafi 2 pika (ii) i KPPPK)***

29. I pandehuri vazhdimisht ka pa kërcënime të dhunshme direkte dhe indirekte kundër viktimave dhe dëshmitarëve në këtë procedurë penale, ndaj Gj. L. M. N. dhe B. L. Dënimi i mëparme ndaj të pandehurit si i mitur për Vrasje, aktakuza e parashtruar nga Gjykata Federative e SHBA, Distrikti Jugor i Nju Jorkut, për vepra të dhunshme kundër personave dhe duke bashkëpunuar me familjet kryesoret krimin të organizuar, dhe reputacioni i tij si person të dhunshëm dhe kriminel në komunitetin e Pejës, mbështetë konkludimin se viktimat dhe dëshmitarët kanë baza të arsyeshme të besojnë se i pandehuri do ti përmbush kërcënimet të cilat i ka ba ndaj tyre.

30. Me 6 gusht 2008, axha i të pandehurit P██ K██, ka shkuar në shtëpi të palës së dëmtuar Gj██ L██ dhe është munduar ta bindë se i pandehuri nuk është përgjegjës për rrëmbimin dhe vrasjen e P██ L██. Kjo tregon se edhe derisa ai është në paraburgim ai përdorë anëtarët e familjes së tij për të ndikuar në dëshmitar.

***Serioziteti i veprës penale dhe karakteristikat personale, sjellja e kaluar, dhe rrethanat tjera personale tregojnë se ekziston rreziku se Gjelosh Krasniqi do ta kryej veprën penal të cilën po kërcënohet se do ta kryej (neni 281, paragrafi 1, nën-paragrafi 2, pika (iii) e KPPPK)***

31. *Krimet e luftës kundër popullatës civile* është një ndër veprat ma të rënda penale, e sidomos kur vepra penale në fjalë përfshinë zhdukjen e dhunshme dhe vrasjen e civilëve.

32. I pandehuri më parë është i dënuar si i mitur për veprë penale të vrasjes, dhe sikurse që ceket në paragrafët e lartpërmendur 28 (A) - (C) ai është i akuzuar nga Gjykata Federative e SHBA, Distrikti Jugor i Nju Jorkut për veprat penale të bashkëpunimit me familjen kryesore të krimit të organizuar.

***Masat tjera të parapara në nenin 268, paragrafi 1, nuk janë të mjaftueshme që ta sigurojnë prezencën e Gjelosh Krasniqi, që ta parandalojnë përsëritjen e kryerjes së veprës penale dhe të sigurojnë zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale (neni 281, paragrafi 1, nën-paragrafi 3 i KPPPK)***

33. Rreziku shumë i lartë se i pandehuri do të arratiset, kërcënimet e tija të përsëritura me dhunë kundër dëshmitarëve dhe viktimave, dhe e kaluara e tij e përforcuar si recidivist, demonstroi se premtimet nga ana e tij se do të qëndroj në Kosovë, ndalesa ti afrohet njerëzve të caktuar, paraqitja në stacionin e policisë, dorëzania, dhe burgu shtëpiak nuk do të ishin të mjaftueshme për ta parandaluar ate që të arratiset, të ndikoj dhe ti kërcënohet dëshmitarëve, dhe të mos kryej vepra tjera penale.

E parashtruar me respekt

\_\_\_\_\_  
Deborah Wilkinson  
Prokurore publike ndërkombëtare e qarkut